



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 98

Prishtinë, më 10.2.2014, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S1

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi, Behar Selimi, Mufera Shinik, Ardian Gjini, Halit Krasniqi, Haki Demolli, Armend Zemaj, Albulena Haxhiu dhe Sreten Ivanoviq.

Munguan: Arsim Bajrami dhe Gëzim Kelmendi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati – ZPRK; Lejla Selimi, Petrit Hysaj, Dukagjin Bokshi – OSBE; Artan Canhasi dhe Granit Vokshi-EULEX; Fitim Gashi- Koha Ditore; Sylë Ahmeti – Kosova Sot; Liridona Xhemajli – RTV 21; Shkodran Gajraku – Klan Kosova; Vjollca Gjota- IKPZH; Dardan Berisha- IFES; Albert Krasniqi – KIPRED; Blerta Bejtullahu-EUSK/EU; Vlora Nushi – OPA-UNMIK dhe Qëndresë Mustafa – BIRN.

Nga stafi i Komisionit për Legjislacion: Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 27.1.2014;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 27.1.2014

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 27.1. 2014, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës

Kryetari, tha se nga mbledhja e kaluar ishte vendosur që nesër dhe pasnesër të mbahet një punëtori, mirëpo Kryesia e Kuvendit ka caktuar seancën e radhës, andaj punëtorja anulohet. Propozoi që ditën e premte, më 14.2.2014, të fillojmë me shqyrtimin e Projektligjit nën për nën, ku do të punohet mbi draftin e spastruar nga administrata dhe do të ftohen të gjitha grupet e interesit. Është me interes që të intensifikohet puna e Komisionit, dhe nëse është nevoja, mund të punojmë edhe ditën e shtunë.

Albulena Haxhiu, tha se është bërë mirë që punëtorja është anuluar, sepse unë edhe ashtu kam qenë kundër që këto debate që lidhen me reformën zgjedhore, të mbahet jashtë, sepse çështjet e tilla duhet të bëhen në institucione, pra në Kuvend, në mënyrë që të përfshihen shoqëria civile dhe mediat.

Halit Krasniqi, tha se Partia Demokratike është e disponuar që të punohet në reformën zgjedhore kudo qoftë, në Kuvend apo ndokund tjetër, me prezencën e mediave dhe shoqërinë civile. Jemi që përmes kësaj reforme të përfshihet edhe vullneti i të gjitha subjekteve politike për të gjitha çështjet që na kanë dalluar deri tash.

Behar Selimi, tha se nëse po mendohet që sot një javë të futet në rend dite në seancë plenare, është gabim, sepse fillimisht Projektligjit duhet t'i dërgohet Qeverisë për mendim, para se të përcillet për lexim të parë. Ky është vetëm aspekti procedural që duhet të ndiqet.

Kryetari, duke u ndërlidhur me parafolësin, sqaroi se fjala është për shqyrtim të Projektligjit në Komision dhe pasi të pajtohemi me versionin final, do ta procedojmë tutje. Po ashtu, propozoi që z. Idriz Tahiri të angazhohet si ekspert për Projektligjin në këtë fazë të hartimit dhe në fazën e amendamentimit.

Meqë nuk kishe diskutime tjera, kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime, nxori këtë:

P ë r f u n d i m

I. Takimi i radhës së Komisionit do të mbahet të premten, dt. 14.2.2014.

II. Komisioni vendosi që ekspert për ofrimin e mbështetjes profesionale të Komisionit për hartimin e Projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, caktohet z. Idriz Tahiri.

Mbledhja përfundoi në orën 12:35.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit
Arben Gashi
